



## KUVENDI I SHQIPËRISË

### *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Tiranë më, 19.11.2019

Dokument parlamentar

### **RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020”**

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, në mbledhjet e tij të datës 18 dhe 19 nëntor 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Ilir BEQAJ.

Komisioni zhvilloi 5 seanca për shqyrtimin në parim të projektbuxhetit ku u njoh me projektbuxhetin në tërësi nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, me projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe me projektbuxhetin Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Komisioni u njoh me parashikimet e treguesit kryesorë të projektbuxhetit të vitit 2020 nga Ministria e Financave znj. Anila DENAJ dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie. Mbledhja u zhvillua në datën 18 nëntor 2019.

Projektbuxheti i vitit 2020 dhe projektbuxheti afatmesëm në tërësi, vijnë në mbështetje të vazhdueshme të reformave të Qeverisë Shqiptare për rritje cilësore dhe të qëndrueshme të ekonomisë, punësimit, shërbimeve ndaj qytetarëve dhe avancim në procesin e aderimit në familjen europiane.

Ky projektbuxhet konsiderohet si vijim i konsolidimit financiar dhe financa publike të forta, stabilitet financiar dhe qëndrueshmëri të pozicionit të jashtëm të Shqipërisë. Në terma të politikave dhe indikatorëve makroekonomikë ky buxhet synon:

- Realizimin e një rritjeje ekonomike, e cila parashikohet të jetë në nivelin 4.1% në vitin 2020. Kjo rritje parashikohet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si konsumi ashtu edhe investimet.
- Sigurimin e një niveli të lartë të investimeve publike prej mbi 4.5% e Produktit të Brendshëm Bruto, në mbështetje të rritjes ekonomike dhe punësimit.
- Ruajtjen e Balancës Primare Pozitive. Kjo balancë do të jetë pozitive për të pestin vit rradhazi në nivelin 0.7% duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse. Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulet në nivelin e 62.2% të PBB-së.
- Mbajtjen e defiçitit buxhetor nën nivelin e 2%. Për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të PBB-së.

- **Të ardhurat**

Parashikimi i të ardhurave për Buxhetin e vitit 2020, është bazuar në vlerësimin rigoroz të rezultatit të pritshëm për vitin 2019. Të ardhurat për vitin 2020 janë parashikuar rreth 502.7 miliardë lekë. Në parashikimin e të ardhurave janë faktorizuar në mënyrë të ndërlidhur edhe variablat makroekonomikë me faktorët kryesorë që ndikojnë në taksa specifike.

Elementët kryesorë që janë faktorizuar në parashikimin e të ardhurave janë:

- Rritja nominale e Produktit të Brendshëm Bruto;
- Kursi i pritshëm i këmbimit;
- Sasitë e pritshme të importit të mallrave në përgjithësi, dhe atyre me regjim akcize në veçanti
- Programimi i fondeve të nevojshme për rimbursimin e tatimpaguesve, me qëllim uljen e stokut në fund të vitit 2020 me rreth 67 % krahasuar me stokun e pritshëm në fundin e vitit 2019

- **Shpenzimet**

Shpenzimet buxhetore të programuara për vitin 2020 janë rreth 532 miliardë lekë ose rreth 29.7% e Produktit të Brendshëm Bruto. Ato rriten me rreth 5.1% krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Prioritet në Buxhetin 2020 mbetet mbështetja për sektorët prioritarë, për arsimin, shëndetësinë, bujqësinë dhe infrastrukturën. Këto sektorë janë kyc në ecurinë e një modeli ekonomik që sjell zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje që ndikon jetesën e qytetarëve në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Shpenzimet kapitale ose Investimet Publike do të pësojnë një rritje 4.7% në raport me PBB-në dhe rreth 4% krahasuar me të pritshmin e vitit 2019.

Në planifikimin e investimeve për vitin 2020 janë mbajtur në konsideratë të gjitha detyrimet kontraktuale për projektet e investimeve me financim të huaj dhe të brendshëm. Në vitin 2020 do të vazhdojë të ketë përparësi financimi i projekteve në vazhdim, duke synuar mbylljen e tyre brenda vitit 2021.

- **Defiçiti buxhetor**

Defiçiti buxhetor për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të PBB-së. Ky përbën nivelin më të ulët të synuar në dy dekadat e fundit. Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulet në nivelin e 62.2% të PBB-së. Financimi i defiçitit do të realizohet nëpërmjet burimeve huamarrjes së brendshme në rreth 1.3% të PBB-së, huamarrjes së huaj në rreth 0.8% të PBB-së ku parashikohet edhe emetimi i një eurobondi tjetër. Ndërkohë parashikohet të ketë një akumulim shtesë të gjendjes së depozitës në TSA gjatë vitit 2020 prej rreth 0.4% e PBB-së.

### **MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në mbledhjen e datës 18 nëntor 2019. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri Z. Bledi Çuçi. Të pranishëm ishin edhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Buxheti i vitit 2020 në terma financiar është rreth 11,4 mld lekë ose 15% më i lartë se në vitin 2019.

Buxheti i vitit 2020 për sektorin e bujqësisë do të mbështesë disa reforma thelbësore, dhe konkretisht:

- Reformën në sektorin e veterinarisë;
- Ristrukturimin e AKU-së;
- Mbeshtetjen financiare për sektorin (IPARD+skema kombetare); si dhe
- Investimet në infrastrukturën bujqësore dhe sigurinë ushqimore.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mëposhtme sipas programeve të mëposhtme:

- **Zhvillimi rural dhe mështetja për fermerin**

Objektivat e këtij program janë:

- rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore dhe blegtorale përmirësimi i standardeve dhe garantimi i sigurisë ushqimore, si dhe zhvillimi i zonave rurale për një zhvillim bujqësor dhe rural të qëndrueshëm përmes nxitjes së shumëllojshmërisë së veprimtarive ekonomike në zonat rurale, duke rritur numrin e të punësuarve në bujqësi dhe agropërpunim;
- sipërfaqet e mbjella me fruta dhe perime; si dhe
- aktivitetet promovuese të produkteve shqiptare në bujqësi, blegtori dhe agropërpunim.

Objektiv tjetër i rëndësishëm është arritja e standarteve të BE-së, në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural, nëpërmjet shtimit të numrit të përfituesëve nga skema e masave mbështetëse në bujqësi në 2450 përfitues në vitin 2022, dhe nëpërmjet certifikimit dhe testimit të farave dhe fidanëve që hidhen në treg në mënyrë që të sigurohen inpute cilësore për bujqësinë.

Fondi i parashikuar për skemat kombëtare është **843 milion lekë**. Skema është në proces diskutimi dhe konsultimi për identifikimin e sektorëve që do të mbështeten dhe masat mbështetëse përkatëse, komplementare me programin IPARD II dhe shmangein e mbivendosjeve. Do të vazhdojë praktika e nisur për aplikimin me zero dokumenta për masat direkte;

- **Siguria Ushqimore**

Nëpërmjet programit “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit” synohet fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë.

Synimet kryesore të Programit “Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorit” për vitin 2020 lidhen kryesisht me reformën veterinarë dhe forcimin e sigurisë ushqimore.

Me buxhetin e vitit 2020 fillon zbatimin reforma në fushën e veterinarisë. Gjatë këtij viti buxhetor synohet rritja me afërsisht 2.5 herë e numrit të veterinerëve duke mundësuar ofrimin e shërbimit veterinar sa më afër fermerit.

- **Peshkimi**

Qëllimi i këtij programi është menaxhimi i peshkimit dhe akuakulturës duke mbështetur sektorin me politika strukturore për tregjet, politikat tregtare dhe politikat ndërkombëtare, me qëllim zhvillimin e aktivitetit të peshkimit në përputhje me standardet e BE-së, si dhe duke garantuar konkureshmërinë e mbrojtjen e resurseve.

Në vitin 2020 do të bëhet i mundur investimi në Markatën e peshkut Vlorë prej 190 mln lekë dhe do të vihet në funksionim sistemi BluBox me një financim prej 165 mln lekësh..

Gjithashtu do të hapet mundësia për kredinë italiane prej 25 mln euro, për rehabilitimin e 3 porteve të peshkimit dhe ndërtimin e disa moleve për peshkimin e vogël artizanal.

- **Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit**

Në total buxheti i këtij programi është rreth 3.16 miliard lekë, nga të cilat 2.45 miliardë lekë investime (1.7 miliardë lekë investim i brendshëm dhe 0.75 miliardë lekë investim i huaj) dhe 0.71 miliardë lekë shpenzime.

*Në ujitje*

- Me financim rreth 563 milion lekë, nga të cilët rreth 420 milion do përdoren për vazhdimin e financimit për përfundimin e punimeve në 22 skema ujitëse të bashkive (vazhdim nga viti 2019);
- Rehabilitimi i disa skemave ujitëse në administrim të MBZHR (skema ujitëse me rezervuarin e Doftisë në Gjirokastrë, skema ujitëse e Armenit për bashkinë Selenicë, kanali ujitës i Postribës në bashkinë Shkodër dhe Kanali ujites U13 në bashkinë Kurbin).

Impakti i pritshëm është përmirësimi i ujitjes në rreth 17 mijë ha, nga të cilat 13 mijë ha nga përfundimi i rehabilitimit të 22 skemave ujitëse të bashkive.

Me Projektin e Burimeve Ujore dhe Ujitjes të Banka Botërore, gjatë vitit 2020, do përfundojë rehabilitimi i 7 skemave ujitëse, vazhdim nga viti 2019 (Dega e Lushnjes dhe Dega e Çukasit në Lushnje, skema Leminotit në Maliq, Skema e Sllanicës në Urën Vajgurore, skemat Tregtan nr.2 dhe Tregtan nr.2 në Has), si dhe skemës ujitëse e Janjarit që shtrihet në bashkitë Konispol), duke e çuar në 21 000 ha sipërfaqen e rehabilituar nga ky project.

*Në mbrojtje nga përmbajtjet:*

Me financimin prej rreth 627 milion lekë parashikohet të ndërhyet në rreth 15 objekte të mbrojtjes nga përmbajtja, kryesisht në lumenjtë Shkumbin, Drin i Zi, Vjosë, Seman dhe Drinos. Rehabilitimi i Kanaleve të Ujërave të Larta, në zonën e Kurbinit dhe të Mamurrasit, ku dhe kemi patur problematika më të mëdha nga rreshjet e ditëve të fundit.

Këto ndërhyrje do të mundësojnë rehabilitimin/ndërtimin e rreth 25 km argjinatura mbrojtëse dhe sistemimin e rreth 27 km të Kanaleve të Ujërave të Larta në Kurbin, duke minimizuar rrezikun nga përmbajtja në zonat, që i përkasin bashkive Lushnje, Dibër, Rogozhinë, Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Berat, Kurbin etj.

Rreth 60 milion lekë, do të përdoren për rikonstruksionin e plotë të hidrovorit të Çukës, në Sarandë për garantimin e kullimit për rreth 900 ha tokë bujqësore

Gjithashtu, do të pastrohen rreth 235 km kanale kryesorë kullues dhe rreth 65 km kanale kryesorë ujitës si dhe mbajtja në gatishmeri teknike të 27 hidrovoreve.

Këto punime të mirëmbajtjes, synojnë ruajtjen e ritmit të punës ciklike vjetore, për përmirësimin e ujitjes në rreth 25 mijë ha (para sezont ujitës), përmirësimin e kullimit në rreth 45 000 ha, si dhe garantimin e kullimit me ngritje mekanike për 70 mijë ha.

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2020 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, u përqëndruan kryesisht në:

- funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit dhe në mirëmbajtjen e kësaj infrastrukture nga pushteti vendor;

- funksionimin e skemës së mbështetjes për fermerët dhe ndërtimin e tregjeve për grumbullimin e produkteve bujqësore të paktën në ato zona që kanë bujqësi të zhvilluar;
- mundësinë e subvencionimit të produkteve plehëruese;
- gjetjen e një mekanizmi të përshtatshëm për rimbursimin e TVSH-së në import, nëse do jetë tek fermeri apo tek pikat e grumbullimit;
- forcimin e kontrollit për sigurinë ushqimore në të gjitha aspektet e saj dhe forcimin e institucioneve që lidhen me të.

### **MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT**

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në mbledhjen e datës 19 nëntor 2019. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministri z. Blendi Klosi dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

Buxheti i Ministrisë së Mjedisit për vitin 2020 do të jetë rreth 2.405 miliardë lekë dhe në tërësinë e tij, shënon një rënie krahasuar me një vit më parë.

Nëpërmjet këtij buxheti synohet përmbushja e objektivave të mëposhtme si:

- **Zhvillimi i turizmit**

Turizmi ka gjeneruar një rritje me 10% për numrin e turistëve. Turizmi ka rritje edhe në ndikimin e tij në produktin e përgjithshëm bruto. Mbështetja buxhetore që merr turizmi në këtë buxhet është më e ulët se ajo e vitit aktual përse i përket investimeve. Ky sektor tashmë është shndërruar në një industri të mirëfilltë dhe ka marrë vëmendjen e duhur nga buxheti i vitit 2020 jo vetëm me mbështetje me investime nga buxheti i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit por edhe me mbështetje direkte nga investime në sektorë të tjerë.

Për vitin 2020 synohet forcimi i destinacionit turistik në disa bashki të vendit të përzgjedhura nga një projekt i Bankës Botërore.

Gjithashtu, parashikohen investime në politikat që lidhen me shndërrimin e Shqipërisë në një destinacion turistik alternative. Ndërkohë që investimet në infrastrukture rrugore e aeroportuale, në ujësjellës – kanalizime, në mjedis, në rritjen e kapaciteteve nga shkollat e edukimit profesional, etj janë një mbështetje direkte e këtij sektori.

Projekt i veçantë në turizëm për vitin 2020 është projekti Blu i cili konsiston në hapjen e Shqipërisë ndaj turizmit detar duke krijuar një sistem turizmi marin i cili duhet ndihmuar e promovuar me lehtësira fiskale e administrative.

- **Mjedisi**

Prioritet për mjedisin vazhdojnë të mbeten programe që shkojnë drejt zhvillimit të qëndrueshëm të tij.

Objektivat për mjedisin fokusohen në:

- përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe mjedisit urban;
- monitorimi i cilësisë së ujërave;
- lehtësimi i lejeve mjedisore për veprimtari që janë të rënduara padrejtësisht me këto leje;
- fushatën për të mundësuar që Shqipëria të jetë vendi i parë pa qese në Europë;
- largimin e venddepozitimeve të mbetjeve nga shtratet e lumenjve dhe mbylljen e venddepozitimeve ilegale;
- edukimin e brezave të rinj me kujdesin ndaj mjedisit dhe minimizimin e ndotjeve;
- ngritjen e kapaciteteve të pushtetit vendor në përmbushjen e rolit të tij për ruajtjen e mjedisit;
- integrimin e ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave dhe bujqësisë, zhvillimit urban dhe infrastrukturës;

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2020 për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, u përqëndruan kryesisht tek:

- mbrojtja e mjedisit;
- monitorimi i saktë i zonave bregdetare;
- promovimi i edukimit mjedisor;
- konstatimi i një fiktiviteti në marrjen e mendimit të publikut në ndërtimin e HEC-ve të vogla;
- ecuria e administrimit të pyjeve dhe moratoriumit të pyjeve;
- monitorimi i moratoriumit dhe nevoja për lëndë drusore në disa zona të caktuara;
- procesi i menaxhimit të mbetjeve dhe format që kanë prioritet në këtë proces sipas politikave të ministrisë, si dhe orientimi i pushtetit vendor drejt tyre në varësi të madhësisë e specifikave që ka secila bashki.

Në lidhje me turizmin, Komisioni u shpreh që buxheti i akorduar për turizmin është modest dhe nuk reflekton mbështetjen që duhet të ketë në raport me rritjen që ka shënuar në vitin 2019 dhe me faktorë të ndryshëm që ndikojnë tek ai. Shqetësime u shprehën në lidhje me investimet në turizëm dhe diversifikimi i tij në mënyrë që të jetë i konkureshëm dhe atraktiv; të shihet raporti i akorduar për turizmin mes investimeve në zëra të ndryshme që ndikojnë në mënyrë indirekte në turizëm; etj.

## **MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**

Komisioni shqyrtoi projektbuxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në mbledhjen e datës 19 nëntor 2019. Projektbuxheti i kësaj ministrie u paraqit nga Ministria Znj. Belinda Balluku dhe përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

### **Orientimet kryesore të buxhetit 2020 të MIE janë:**

1. Zgjerimi i rrjetit të rrugëve kombëtare nëpërmjet, ndërtimit, rehabilitimit dhe sistemimit të rrugëve kombëtare dhe përveç kësaj kalimin në praktikat e mirëmbajtjes së rrugëve bazuar në performancë

2. Zgjerimi i aksesit dhe cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve përmes: një portofoli të investimeve publike dhe përmirësimit rrënjësor të menaxhimit të shoqërive aksionere të ujësjellës kanalizimeve, duke standartizuar parimet e qeverisjes së sektorit;
3. Rritja e efikasitetit të energjisë kundrejt konsumit të përgjithshëm final të energjisë sipas shqyrtimit të programeve për promovimin e tregut, tërheqjes së teknologjive të avancuara, rritjen e peshës së gjenerimit të energjisë së rinovueshme;
4. Trajtimi i mbetjeve në mënyrë të kontrolluar sanitare, si: vazhdimi i ndërtimit të impianteve të reja të trajtimit të mbetjeve të ngurta, dhe rehabilitimi i venddepozitimeve ekzistuese.

Fokusi i investimeve do të jetë në zgjerimin e rrugëve kombëtare, zgjerimin e aksesit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, rritjen e efikasitetit të energjisë; trajtimin në mënyrë të kontrolluar sanitare të mbetjeve.

Ky buxhet synon të përmbushë objektivat e mëposhtme sipas fushave:

- **Energjia**

Ndërkohë, në sektorin energjistik mbështetje me financim gjatë vitit 2020 do të kenë projektet në funksion të përmbushjes së politikave dhe prioriteteve të Qeverisë për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Pjesë e rëndësishme e programit është diversifikimi i prodhimit të energjisë, si dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe Europiane, duke nxitur kështu investimet në këtë sektor.

Në terma konkretë ky program synon të arrijë furnizimin e pandërprerë të konsumatorit me energji elektrik, rritjen e efikasitetit të energjisë 6.5% referuar vitit 2019 dhe rritjen e prodhimit dhe përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme në masën 38%.

Mbështetja për energjinë do të vazhdojë edhe këtë vit. Objektivat kryesore janë si më poshtë:

- Zhvillim i qëndrueshëm i ekonomisë nëpërmjet garantimit dhe furnizimit me burime të sigurta energjetike me kosto minimale;
- Diversifikimi i furnizimit me burime energjetike dhe integrimi në rrjetet energjetike rajonale dhe Europiane, duke nxitur investimet dhe përmirësuar arkëtimet dhe likuiditetet;
- Në vitin 2020 do të rritet përdorimi i energjisë së rinovueshme me 38% kundrejt vitit 2019;
- Në vitin 2020 do të rritet efikasiteti i energjisë me 6.5% referuar vitit 2019.

- **Infrastruktura**

#### *Transporti rrugor*

Programi i Transportit Rrugor synon rritjen e standardeve, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit kombëtar të rrugëve, veçanërisht të korridoreve dhe akseve për në destinacionet kufitare dhe turistike.



Objektivi kryesor është mbështetja financiare për krijimin e një rrjeti transporti të qëndrueshëm që nënkupton uljen e kostove, rritjen e sigurisë rrugore, rritjen e shpejtësisë së lëvizjes, si dhe përmbushjen e standardeve mjedisore.

Më kryesoret për vitin 2020 mund të konsiderohen investimet në:

- Ndërtimin e rrugës Kardhiq - Delvinë Loti 8
- Subvencionin e Kontratës koncesionare "Për ndërtimin, përmirësimin, shrytëzimin, mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e autostradës Milot - Morinë “,
- Financimin e rrugës së Arbrit plus supervizionin;
- Rritjen e sigurisë rrugore në të gjitha akset kombëtare; etj.

#### *Transporti ajror*

Programi i Transportit Ajror është një program, i cili dhe në kuadër të Planit Kombëtar të Zhvillimit të Aviacionit Civil, po merr përparësi si një ndër fushat e përgjegjesisë së MIE që do të sjellë zhvillim të konsiderueshëm infrastrukturor e ekonomik për vendin. Tashmë ky program po merr një dimension të ri, atë të zhvillimit dhe ndërtimit të infrastrukturave të reja aeroportuale, me qëllim krijimin e një tregu konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara.

Si objektiva kryesore mund të rendisim sa më poshtë:

- Rritja e standarteve dhe performancës së Organit Kombëtar të incidenteve/Aksidenteve ajrore nëpërmjet investimeve për forcimin e kapaciteteve, në kuadër edhe të ndërtimit të infrastrukturave të reja aeroportuale;
- Numri i investigimeve të kryera në vitin 2022 të arrijë në 5 nga 4 investigime që pritet në 2020;
- Zbatimi i standarteve të njehsuara të sigurisë dhe parrezikshmërisë në transportin ajror.

#### *Transporti Detar*

Programi i Transportit Detar mbulon me financim realizimin e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës, rritjen e kapaciteteve njerëzore, dhe përmirësimin e sigurisë dhe sistemit të menaxhimit në porte.

Si objektiva kryesore mund të rendisim sa më poshtë:

- Kryerja e investimeve prioritare për funksionimin me kapacitet të plotë të porteve dhe përmirësimin e infrastrukturës portuale në vend, me qëllim shndërrimin e Shqipërisë në një vend të zhvilluar detar që mbështet rritjen ekonomike dhe shpejton procesin e integritimit në BE;
- Rritja e volumit të përpunimit të mallrave në porte në masën 40% në vitin 2022 nga 25% që është aktualisht në 2019

#### *Transporti Hekurudhor*

Transporti hekurudhor konsiderohet si një transport me kosto të ulët e kohë të shpejtë zhvendosjeje, si dhe miqësor me mjedisin.

Si objektiva kryesorë mund të rendisim sa më poshtë:

- Rikonstruksioni i segmentit hekurudhor Tiranë – Durrës si dhe ndërtimi i linjës së re hekurudhore Tiranë-Rinas, tenderimi i të cilës fillon në fillim të vitit 2020;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore ekzistuese si dhe mirëmbajtja e mjeteve-hekurudhore; Studime fizibiliteti dhe projekte zbatimi për segmente të reja dhe ekzistuese hekurudhore.

- **Mbetjet urbane**

Objektivat kryesore për trevjeçarin janë si më poshtë:

- Në vitin 2022, synohet që të trajtohen rreth 50% të mbetjeve me landfill-e sipas standardeve;
- Norma e ndotjes së ajrit synohet të arrihet në 39  $\mu\text{g}/\text{m}^3$  në 2022 nga 45  $\mu\text{g}/\text{m}^3$  që pritet të arrihet në fund të 2019;
- Norma e mbetjeve të rikuperuara kundrejt sasisë totale të mbetjeve të prodhuara synohet të arrihet në 30% në 2022 nga 3% që synohet në fund të 2019;

- **Furnizim me ujë dhe kanalizime**

Programi i Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime është hartuar në përputhje me prioritetet e qeverisë për reformën e ujit dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë, dhe mbulon me financimin funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve.

Në hartimin e politikave të reja janë marrë në konsideratë 2 objektivat kombëtare si angazhimi kryesor i MIE në sektorin e ujit për 3 vitet në vazhdim që janë reduktimi i humbjeve në nivel kombëtar deri në masën 50% në vitin 2022 dhe furnizimi me ujë dhe shërbime i zonës bregdetare 24 orë/ditë në vitin 2022.

Diskutimet në Komision, gjatë shqyrtimit në parim të projektbuxhetit 2020 për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, u përqëndruan kryesisht në:

- gjendjen aktuale të infrastrukturës rrugore e standardet e saj, si dhe në projekte të veçanta siç është ai i Korridorit të tetë si i vetmi koridor Paneuropian që kap Shqipërinë;
- zhvillimet në infrastrukturën hekurudhore dhe konkretisht linja Tiranë – Rinas – Durrës, si dhe mundësinë e lidhjes me linjë hekurudhore me rrjetin ndërkombëtar;
- mbulimin me financim për projekte të ndryshme infrastrukture; parashikimin e një fondi të veçantë për studim fizibiliteti të projekteve infrastrukture;

- menaxhimin e mbetjeve urbane dhe problematikat e tyre si në grumbullim, venddepozitime apo incineratorë;
  - problematikat në furnizimin me ujë dhe projektet në infrastrukturë e ujësjellës – kanalizime dhe përfitimi i zonave rurale prej tyre; investimet në sektorin e energjisë;
  - diversifikimin e burimeve të energjisë;
  - ecurinë e linjave të interkoneksionit në ndërtim;
  - perspektivat e zhvillimit të Air Albania;
  - perspektivat e zhvillimit të Albpetrolit; etj.
- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 158 të Kushtetutës.


Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 21 nene.

- ***Përfundime***

Pasi u njohën me projektbuxhetin e vitit 2020 për secilën nga ministritë e mësipërme, në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash u shpreh dakord në parim me projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”. Deputetët e opozitës të pranishëm votuan kundër.

**Ilir BEQAJ**  
  
**Relator**

**Niko PELESHI**  
  
**Kryetar**



## KUVENDI I SHQIPËRISË

### *Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin*

Tiranë më, 9.12.2019

Dokument parlamentar

### **RAPORT PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2020” (nen për nen)**

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 dhe nenin 80 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”, në mbledhjen e datës 9 dhjetor 2019.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit nen për nen të projektbuxhetit të vitit 2020 ishin përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministri i Turizmit dhe Mjedisit e përfaqësues të tjerë të kësaj ministrie.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2020” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83 pika 1, dhe 158 të Kushtetutës, si dhe të nenit 30, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 3 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Rekomandime për Komisionin përgjegjës***

Për shkak të situatës së emergjencës së krijuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, kanë lindur një sërë nevojash të reja për financime dhe për këtë arsye duhen bërë ndërhyrje në buxhetin e vitit 2020.

Disa nga këto ndërhyrje të domosdoshme sipas ministrive përkatëse janë si më poshtë:

1. Komisioni u njoh me kërkesat e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, e cila pas situatës së krijuar nga tërmeti i datës 26 nëntor, ka identifikuar nevoja shtesë për financim në programin 04240 “Infrastruktura e Kullimit dhe Ujitjes” në shumën e 1 miliardë lekëve. Kjo për shkak të ndërhyrjeve rikonstruktive që duhen bërë në disa diga, si dhe në disa ndërtesa të agjencive zbatuese siç është ajo e ISUV-it dhe AKU-së.
2. Komisioni u njoh me kërkesat e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë si më poshtë:
  - parashikimin e hapjes së fondeve për fillimin e punimeve të Hekurudhës Durrës – Tiranë – Rinas, procedura e konkurrimit e së cilës do të kryhet në fillim të vitit 2020;
  - parashikimin e fondeve për studim fizibiliteti të projekteve të ndryshme infrastrukturore;
  - përveç kërkesave të mësipërme, tashmë me situatën e krijuar nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, kërkohet të parashikohen fonde shtesë për ndërhyrje në Urën e Dajlanit dhe Urën e Shijakut;
3. Përfasësuesi i Ministrisë së Financave sqaroi se për shkak të situatës së krijuar nga tërmeti i datës 26 nëntor po punohet për ta përshtatur buxhetin 2020 me kërkesat e reja emergjente të krijuara, por akoma nuk është arritur sistemimi i plotë i tyre.

Pasi i njoh me nevojat e mësipërme për shtesë në financime dhe për shkak të një pamje jo të qartë të ndërhyrjeve që do të bëhen në buxhetin e vitit 2020 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Komisioni vendosi t’i rekomandojë ato për shqyrtim tek komisioni përgjegjës.

Gjithashtu, gjatë shqyrtimit nen për nen të projektligjit, Komisioni i rekomandon komisionit përgjegjës që:

- Në nenin 5, në fjalinë e parë të paragrafit të fundit fjalët “përfshirë dhe detyrimet e prapambetura” të hiqen;
- Në nenin 20, të vendosen referencat e neneve në zbatim të të cilave detyrohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë të nxjerrë udhëzime për zbatimin e ligjit të buxhetit 2020.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni me shumicë votash, vendosi miratimin nen për nen dhe në tërësi të projektligjit “Për buxhetin e vitit 2020”.

**Eglantina GJERMENI**

  
**Relator**

**Niko PELESHI**

  
**Kryetar**